

UDHËZIM
Nr. 4/1, datë 9.6.2014

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 4, DATË 11.4.2014,
“PËR PROCEDURAT DHE MËNYRËN E ADMINISTRIMIT TË FONDIT TË
PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL”**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, dhe pikës 8 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 173, datë 26.3.2014, “Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural”,

UDHËZOJMË:

Në udhëzimin nr. 4, datë 11.04.2014, “Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Fjala “Aneksi 1” në germën b, të pikës 1.1, të masës 1, “Mbështetje për dorëzimin e prodhimit të frutave dhe perimeve”, ndryshohet si më poshtë:

Aneksi 1/1, që i bashkëngjitet këtij udhëzimi.

Në formularin nr. 1/2, shtohet fjala: mbas fjalës fruta... shtohet fjala “perime”.

2. Fjala “Aneksi 3”, kudo që përmendet në udhëzim ndryshohet si më poshtë:

Aneksi 3/1, që i bashkëngjitet këtij udhëzimi.

3. Në aneksin 2, formulari 2, “Rajonizimi i vreshtave me destinacion rrush për verë të kuqe...”: Varieteti “Vlosh” mbështetet financiarisht kultivimi edhe në rrethet Berat, Kuçovë dhe Skrapar të qarkut Berat.

4. Në skemën 4, “Përmirësimi i teknologjisë së mbjelljes dhe kultivimit të bimëve medicinale të kultivuara”, bëhen ndryshimet si më poshtë:

Fjala “Aneksin 3”, e përmendur në germën “b”, të pikës 4.1, ndryshohet dhe bëhet “Aneksin 3/1.

Grupi i fjalëve “Specia sipas rajonizimit”, aneksi 4, në germën B, të pikës 4.3, hiqet.

Në shkronjën “d”, verifikimi dhe pagesa, togfjalëshi “Faturën tatimore të blerjes së fidanëve, ku specifikohet sasia dhe lloji i fidanëve të blerë”, ndryshohet me:

“Faturën tatimore të blerjes së fidanëve/farës, ku specifikohet sasia dhe lloji i fidanëve/farës së blerë”.

5. Në të gjitha masat e mbështetjes, ku kërkohet dokumenti që vërteton të drejtën e përdorimit të tokës nga aplikantët të shtohet si më poshtë vijon:

Grupi i fjalëve “dokumenti i pronësisë, përdorimit ose marrjes së tokës me qira”, shtohet si vijon: “i shoqëruar me planvendosjen e parcelës/parcelave, sipas rastit, të nënshkruar dhe vulosur nga ZRPP ose komuna/bashkia” .

Në të gjitha rastet, në udhëzim kur kërkohet dokumenti i pronësisë, certifikata nga ZRPP ose akti i marrjes së tokës në pronësi, mban emrin e një personi që nuk jeton më, aplikanti paraqet certifikatën familjare të trungut të personit që nuk jeton, certifikatën e vdekjes dhe sipas rastit edhe prokurën për të drejtën e aplikimit nga bashkëfamiljarët e trungut.

6. Në skemën nr. 5, “Mbështetja e prodhimit në serra me ngrohje”, pas germës a” shtohet: “Fermer individual”.

Në skemën 5, “Mbështetja e prodhimit në serra me ngrohje” formulari 5/3 zëvendësohet me formularin 5/3.1, që i bashkëngjitet këtij udhëzimi.

7. Në skemën 6, “Ujitja me pika në ullishte, vreshta, pemëtore, agrume”, tek kriteret e përfitimit (6.1), pika “P”, ndryshohet me: “Toka të jetë në pronësi të aplikantit, në përdorim dhe/ose me qira për të paktën 5 vjet nga momenti aplikimit”.

Formulari 6/3, zëvendësohet me formularin 6/3.1, që i bashkëngjitet këtij udhëzimi.

8. Në skemën 9, “Mbështetja e prodhimit të qumështit.” bëhen ndryshime e shtesa si më poshtë: Formulari 9/1 zëvendësohet me formularin 9/1.1 që i bashkëngjitet këtij udhëzimi;

Në fund të skemës, shtohet edhe një pikë tek penalitetet si vijon:

“Kur nga verifikimi në terren konstatohet se procesi i mjeljes së mekanizuar, të deklaruar nga aplikanti në formularin e aplikimit, nuk ekziston, aplikanti penalizohet duke i zbritur 30 % të vlerës së llogaritur të mbështetjes financiare”.

9. Për skemat mbështetëse me nr. 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15 dhe 16, termi “Certifikatë veterinare”, zëvendësohet me termin “Certifikatë veterinare dhe/ose deklarim veterinar”. Ky dokument firmoset dhe vuloset nga inspektori veteriner dhe kryeinspektori veteriner.

10. Në skemën 11, “Mbështetja e fermave blegtorale që mbarështojnë jo më pak se 100 (njëqind) krerë dele ose dhi të matrikulluara”, në formularin 11/6, bëhen ndryshimet për personat që nënshkruajnë si vijon: “Aplikanti” bëhet “Përfaqësuesi i DB” dhe “Përfaqësuesi i ZBRR” bëhet “Përfaqësuesi i AZHBR”.

Formulari 11/6, zëvendësohet me formularin 11/6.1.

11. Në skemën nr. 17, “Mbështetja e sektorit të akuakulturës, në masën 25 % të vlerës së rasatit”, në pikën B, tek statusi i aplikantit shtohet: “Aplikanti individual 5 pikë”.

12. Në skemën nr. 19, “Mbështetja, përmes sub-vencionimit në masën 70% të normës së interesit”, shtohet aktiviteti: “Ndërtim/rikonstruksion i objekteve që shërbejnë për mbarështimin e kafshëve dhe shpendëve, si dhe për përpunimin e produkteve bujqësore, blegtorale, akuakulturës dhe bimëve medicinale.”

13. Në skemën nr. 20, “Mbështetja e investimit deri në 50% të investimit”, në nëntemën 20.1 tek kriteret e përfitimit, në pikën “b” të shtohet paragrafi: “Ngritje/rikonstruksion për stalla/thertore për kafshë dhe shpendë”.

14. Në pikën 20.3, bëhet shtesë pika “e”, me këtë përmbajtje: “Aplikanti të dorëzojë kërkesën për leje ndërtimi, drejtuar komunës/bashkisë.”

15. Shtohet në udhëzim skema me numër 21, si më poshtë:

“21. Mbështetja e prodhimit në serra me ngrohje qendrore përmes financimit të lëndës djegëse, në masën 100 mijë lekë/dynym për serrat që përdorin si lëndë djegëse naftë dhe në masën 80 mijë lekë/dynym për serrat që përdorin si lëndë djegëse solar.

21.1 KRITERET E PËRFITIMIT

a) Përfitues të kësaj skeme mbështetëse mund të jenë:

-Fermer individual;

-Subjekt me status fizik ose juridik;

-Shoqëri të bashkëpunimit bujqësor;

b) Fermerët që kanë serra me ngrohje qendrore (naftë ose solar), me destinacion prodhimin e perimeve;

c) Vlera e përfitimit do të jetë jo më shumë se 100 mijë lekë/ dy, për ngrohje të serrës me naftë dhe 80 mijë lekë/dy, për ngrohjen me solar;

d) Serra të jetë e mbjellë, në momentin e verifikimit;

e) Serra të ketë të montuar dhe funksional sistemin e ngrohjes;

f) Kapaciteti i kaldajës të plotësojë kërkesat e parametrave të serrës;

g) Aplikanti duhet të mos jetë debitor ndaj AZHBR dhe MBZHRAU.

21.2 PROCEDURA QË DO TË NDIQET

A. Aplikimi

Periodha e aplikimit për mbështetjen financiare përfundon më 20 qershor 2014.

AZHBR-ja gëzon të drejtën të shtyjë afatin e aplikimeve deri në 5 ditë.

Aplikimet për mbështetje financiare paraqiten pranë DB-së, sipas formularit të aplikimit (formulari 21/1). Formularët e aplikimit tërhiqen pranë DB-së. Së bashku me formularin e aplikimit dorëzohet edhe dokumentacioni i mëposhtëm:

- a) Fotokopje e kartës së identitetit ose pasaportës biometrike e aplikantit;
- b) Formularit 21/2;
- c) Dokumenti i pronësisë, përdorimit ose marrjes së tokës me qira;
- d) Vërtetim banke për numrin e llogarisë me firmë dhe vulë të njomë.

Pranohet për dokument pronësie një nga dokumentet e mëposhtëm:

-Certifikata e pronësisë ose vërtetim pronësie (ZRPP), të shoqëruar me kartelën e pasurisë së paluajtshme;

-Akti i pronësisë së tokës sipas ligjit nr. 7501, vetëm kur akti i pronësisë është në emër të aplikantit;

-Vërtetim nga komuna/bashkia për tokën në përdorim.

Kur aplikanti merr tokë me qira:

- a) Kontratë qiraje me individë;
- b) Kontratë qiraje me komunat (kontratë tip).

Kontrata e qirasë në të dyja rastet, bazohet në dispozitat e ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, nenet 826-840. Kontrata e qirasë për pasuritë e paluajtshme me natyrë bujqësore për një periudhë mbi 9 vjet, duhet të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohët në regjistrin publik.

Aplikimi, së bashku me dokumentacionin e mësipërm dorëzohet te përfaqësuesi i Drejtorisë së Bujqësisë, i cili plotëson formularin e pranimit (formulari 21/3), bën regjistrimin e aplikimit në regjistrin e qarkut (formulari 21/7). Një kopje të formularit 21/3, i jepet aplikuesit. Përfaqësuesi i DB, brenda datës 23 qershor 2014, dorëzon dokumentacionin përkatës pranë protokollit AZHBR-Qendër Tiranë. DPAP, bën kontrollin administrativ dhe përcakton listën përfundimtare të përfituesve të skemës 21.

Aplikantëve, të cilëve nuk i pranohet aplikimi kanë të drejtë të ankohen me shkrim brenda 5 ditëve pune tek drejtori i DB-së, i cili duhet t’i japë zgjidhje problemit me shkrim (pranimin ose mospranimin e aplikimit), brenda 5 ditëve pune nga momenti i paraqitjes së ankesës.

D. Verifikimi dhe pagesa

Për verifikimin e realizimit të projekteve fituese dhe plotësimin e dokumentacionit për likuidim, në çdo rreth ngrihet “Grupi i verifikimit të projekteve”, i përbërë nga 2 inspektorë të AZHBR-së dhe 1 specialist i fushës, përfaqësues i DB-së të rrethit përkatës. Grupi i verifikimit të projekteve kryesohet nga AZHBR-ja dhe miratohet nga drejtori i AZHBR-së.

Kushti i domosdoshëm për të përfituar mbështetjen nga skemat e buxhetit të shtetit është që në momentin e verifikimit, serra të jetë e mbjellë.

AZHBR-ja dërgon grupin e verifikimit të projekteve, për verifikim në vend të projektut, duke lajmëruar paraprakisht aplikantin ose përfaqësuesin e tij ligjor, për praninë e tij dhe disponibilitetin e dokumentacionit të kërkuar.

Grupi i verifikimit në prani të aplikantit ose të një përfaqësuesi ligjor, bën matjet dhe verifikimet e nevojshme dhe plotëson formularin e verifikimit të projektut (formulari 21/8). Verifikimi përfshin edhe funksionalitetin e kaldajës dhe kushtet teknike.

Nga ballafaqimi i faktit me kriteret e përfitueshmërisë dhe parametrat e paraqitura në aplikim, grupi i verifikimit konfirmon ose jo, faktin nëse gjetjet në teren janë në përputhje me udhëzimin dhe aplikimin e paraqitur.

Formulari i verifikimit firmoset nga aplikanti/përfaqësuesi i tij, dhe gjithë grupi i verifikimit.

Për çdo rast, aplikanti ose ndonjë përfaqësues i grupit të verifikimit mund të bëjë observimet e nevojshme dhe të firmosë për to.

Grupi i verifikimit brenda 2 ditëve nga verifikimi në terren, dërgon formularin e verifikimit (formulari 21/8) në AZHBR Qendër.

AZHBR-Qendër, pas kontrollit administrativ të dokumentacionit bën xhirimin e parave në numrin e llogarisë së përfituesit, në rastet kur aplikimi është në përputhje me kushtet e përfitueshmërisë të skemës përkatëse. Në rast të mospërputhshmërisë së parametrave apo dokumenteve të caktuara me kushtet e përfitueshmërisë, e dërgon aplikimin e refuzuar në DPAP me argumentin përkatës.

16. Për zbatimin e këtij udhëzimi, ngarkohet Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, Ministria e Financave dhe Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL
DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Edmond Panariti

MINISTRI I FINANCEVE
Shkëlqim Cani